



REPUBLIKA E SHQIPERISË
KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË
DHËNAVE PERSONALE

Nr. 93 Prot.

Tiranë, më 23/01/2015

REKOMANDIM

Nr. 07 / datë 23/01 /2015

Në mbështetje të neneve 29, 30 dhe 32 të Ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 "*Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale*" i ndryshuar, si dhe neneve 80-104 të Ligjit nr. 8485, datë 12.05.1999 "*Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë*";

KONSTATOVA:

Në zbatim të Urdhrit nr.185, datë 29.10.2014 të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale është kryer kontrolli administrativ pranë kontrolluesit, "Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare" (AMF), me objekt:

- *Zbatimi nga ana e kontrolluesit i Ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar, si dhe akteve të miratuara nga Komisioneri, gjatë kryerjes së aktivitetit të tij.*

Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare (AMF), në kuptim të Ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008, "*Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale*" i ndryshuar është kontrollues publik, përgjegjës për rregullimin dhe mbikëqyrjen e sistemit financiar, jo bankar dhe operatorëve që ushtrojnë aktivitetin e tyre në këtë sektor. Gjatë ushtrimit të veprimtarisë dhe aktivitetit të tij, ky kontrollues mbledh dhe përpunon të dhëna personale për kategoritë: nëpunës, subjekte të mbikëqyrura (brokera, agjent, vlerësues, aktuarë etj.) dhe persona të siguruar.

Sa i përket mbledhjes dhe përpunimit të të dhënave personale të nëpunësve, Zyra e Komisionerit konstaton se dosjet personale të punonjësve ruhen në ambiente të sigurta dhe aksesimi është i kufizuar vetëm për punonjësën e burimeve njerëzore, duke qënë në përputhshmëri dhe në zbatim të nenit 27 të Ligjit nr. 9887, datë 10/03/2008, "*Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale*" i ndryshuar. Të dhënat administrohen në përputhje me Rregulloren e Brendshme të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare.

Të dhënat e punonjësve dhe dokumentacioni përkatës mbahen për aq kohë sa ekziston marrëdhënia e punës (në zbatim të nenit 5/1/d të ligjit).

Detyrimi për mbrojtjen e konfidencialitetit nga ana e çdo punonjësi parashikohet në "deklaratën e konfidencialitetit", e cila nënshkruhet sipas "Rregullores për konfidencialitetin në Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare".

Konstatohet se kontrolluesi gjatë procesit të mbledhjes së të dhënave personale të nëpunësve dhe gjatë procesit të licencimit të personave fizikë, (agjentë, broker, konsulent financiar etj), nuk realizon detyrimin për informimin e subjekteve të të dhënave personale, sipas detyrimit të nenit 18 të Ligjit nr.9887, datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, i ndryshuar.

Realizimi i informimit konsiderohet mjaft i rëndësishëm pasi, vetëm nëpërmjet tij subjekti i të dhënave vihet në dijeni me të drejtat që gëzon në bazë të ligjit për mbrojtjen e të dhënave personale. Informimi duhet të jetë i dokumentueshëm dhe mund të përfshihet në kontratat e punës me punonjësit, rregulloren e brendshme dhe në dokumentacionin e licencimit, në rastin e profesionistëve në fushën financiare.

Komisioneri konstaton se, në faqen e kontrolluesit nuk parashikohet rubrika “Politikat e Privatësisë”. Në këtë kuadër është e nevojshme që kontrolluesi në faqen e tij në internet të publikojë “Politikat e Privatësisë”, (paketë rregullash) me qëllim, informimin e subjekteve të të dhënave, (subjekte të mbikëqyrura, brokera, agjent, vlerësues, etj.), dhe personave që vizitojnë faqen, t’u bëjë me dije, mënyrat e përpunimit të të dhënave personale, masat e sigurisë dhe ruajtjes së konfidencialitetit, të drejtat e tyre dhe detyrimet e tij si kontrollues.

Komisioneri vlerëson angazhimin e kontrolluesit për realizimin e detyrimit për njoftim, por gjatë kontrollit u konstatuan mangësi për sa i përket plotësisimit të rubrikave (1.2, 3.1, 4.1, 5.1, 7.1, 8.1).

Në këtë kuadër, lind nevoja që në zbatim të nenit 21 të ligjit të kryhet përditësimi i njoftimit. Në rubrikën 1.2 : Personi i kontaktit i cili është në formularin e njoftimit i ngarkuar nga kontrolluesi nuk është më punonjës i kësaj zyre dhe duhet të ndryshohet .

-Në rubrikën 3.1: “Kategoritë e subjekteve të të dhënave personale që përpunohen”, kontrolluesi nuk ka deklaruar kategoritë si më poshtë vijon :

- “Aksionerë” .
- “Subjekte të Mbikëqyrura (Brokera, Agjent, Vlerësues, Aktuarë, etj...)”.

-Në rubrikën 4.1 : “Kategoritë e të dhënave personale që përpunohen”, kontrolluesi nuk ka deklaruar kategoritë si më poshtë vijon :

- “Formimi-Diplomat-Medaljet” .
- “Të Dhëna Identifikimi”.
- “Foto” .
- “Adresa”, “E-mail,” , “Numër telefoni”.

-Në rubrikën 5.1: “Të Dhëna sensitive që përpunohen”, kontrolluesi nuk ka deklaruar të dhënë “Shëndeti”.

-Në rubrikën 7.1 : Kontrolluesi nuk ka deklaruar se përhap të dhëna personale të punonjësve në Bankat e nivelit të Dytë.

-Në rubrikën 8.1: “Transferimi Ndërkombëtar i të dhënave Personale” kontrolluesi nuk ka deklaruar se transferon të dhëna personale në bazë të marrëveshjeve që ka me shtete të caktuara në vende të BE-së si dhe në vende të tjera që nuk janë në listën që i bashkëlidhet Vendimit Nr.3. datë 20.11.2012 “Për përcaktimin e shteteve me nivel të mjaftueshëm të mbrojtjes së të dhënave personale”.

Komisioneri konstaton se, në kuadër të veprimtarisë, akteve ligjore dhe dispozitave rregullatore për funksionimin e institucionit, kontrolluesi ka marrë masat e nevojshme teknike

dhe organizative me qëllim garantimin e sigurisë, integritetin dhe disponueshmërinë e të dhënave dhe sistemeve elektronike për përpunimit e të dhënave. Kontrolluesi ka hartuar politika dhe rregullore në funksion të sistemeve të Teknologjisë dhe Informacionit dhe në veçanti për sistemin online të policave të detyrueshme. Në kuadër të sigurisë së aseteve të institucionit, konstatohen masa teknike dhe organizative për ndalimin e hyrjes për personat e paautorizuar në mjediset e kontrolluesit, mbikëqyrjen e ambienteve të brendshme dhe të jashtme nëpërmjet sistemit të video-vëzhgimit CCTV.

Në lidhje me pretendimet e Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare (AMF) nëpërmjet shkresës nr. 1753/2 prot, datë 19.11.2014 me të cilat kundërshton një nga konstatimet e kontrollit administrativ Zyra e Komisionerit vlerëson se:

Argumentat e paraqitura nga kontrolluesi kanë të bëjnë me konfidencialitetin e ruajtjes së informacionit, me të cilin punonjësi i AMF-së njihet gjatë ushtrimit të detyrës së tij dhe jo me detyrimin që ka AMF-ja si kontrollues për ta informuar punonjësin për përpunimin e të dhënave të tij.

Neni 18, ka si synim përcaktimin e detyrimit që ka kontrolluesi (në rastin konkret AMF-ja) për të informuar subjektin e të dhënave personale:

- për fushën dhe qëllimin e përpunimit
- për personin që do të përpunoj të dhënat
- për mënyrën e përpunimit
- për të drejtën për akses si dhe për të drejtën për korrigjim të të dhënave të tij (por duke mos u kufizuar vetëm në këto të drejta, por duke parashikuar edhe të drejta të tjera që parashikohen në bazë të ligjit për mbrojtjen e të dhënave).

Në rastin e të dhënave të punonjësve konsiderohet i kryer informimi por jo për të drejtat që gëzojnë punonjësit si subjekte të të dhënave. Një gjë e tillë nuk konstatohet e shkruar në asnjë dokument apo rregullore të AMF-së, administruar në dosje.

Më konkretisht sqarojmë se:

-Neni 2 i kontratës individuale të punës, përcakton detyrimet e punëmarrësit për të ruajtur konfidencialitetin e të dhënave të grumbulluara gjatë kryerjes së detyrës. Pra, nuk përfshin detyrimin e AMF-së si kontrollues për informimin e punonjësve në bazë të nenit 18 të Ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 *“Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”*, i ndryshuar.

- Neni 17 i Rregullores për, *“Mbrojtjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale”*, miratuar me Vendimin nr. 93, datë 25.09.2013, përcakton detyrimin e punonjësve për të mbrojtur të dhënat personale dhe përgjegjësitë në rast të mosplotësimit të këtij detyrimi. Në këtë rast nuk jemi përpara informimit të punonjësve lidhur me të drejtat që gëzojnë në kuadër të të dhënave të tyre personale, por synohet përcaktimi i rregullave për ruajtjen e sigurisë së të dhënave në zbatim të nenit 27 të ligjit.

-Neni 42 i rregullores së brendshme të AMF-së, miratuar me Vendimin nr. 7, datë 30.08.200, përcakton sigurinë e ruajtjes së informacionit të klasifikuar, si një kusht që duhet respektuar nga punonjësit e AMF-së, si dhe mospërhapjen e informacionit.

-Në kapitullin 4 të Udhëzimit nr. 4, datë 03.10.2007, *“Mbi parimet dhe rregullat e përgjithshme të informacionit”*, përcaktohen detyrat dhe përgjegjësitë për ruajtjen e sigurisë së çdo punonjësi.

Pra, si konkluzion, në asnjë pretendim të AMF-së nuk parashikohet përfshirja e informimit të subjekteve të të dhënave, (punonjësve), në lidhje me të drejtat që ata gëzojnë në bazë të ligjit.

Në lidhje me pretendimet e ngritura, për dhënien e pëlqimit në Formularin e Vetë deklarimit që synon dhënien e autorizimit, mbi verifikimin e gjendjes gjyqësore në rrugë elektronike, të subjekteve që aplikojnë për licencë, vlerësojmë se, në këtë formular duhet të bëhet përditësimi i ligjit për mbrojtjen e të dhënave personale.

Mosplotësimi i detyrimit për informim, i përcaktuar në pikën 1 të procesverbalit të lënë nga grupi i kontrollit nuk ka lidhje me “Formularin e Vetë deklarimit për verifikimin e gjendjes gjyqësore” por me informimin në Formularin-Kërkesë, për pajisje me licencë “Broker në Sigurime” etj.

Për qëllime licencimi përpunohen një kategori më e madhe të dhënash personale se sa parashikohet në formularin e vetë deklarimit (bazuar në listën e dokumenteve të domosdoshëm për regjistrimin për qëllime licencimi). Për këtë arsye është e nevojshme që edhe në formularët nëpërmjet të cilëve mblidhen këto të dhëna të parashikohet detyrimi për informim.

Autoriteti i Komisionerit ka mbajtur qëndrimin që në çdo formular për mbledhjen e të dhënave, të parashikohet detyrimi për informim, sipas nenit 18 të Ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, i ndryshuar.

Kontrolluesi AMF, nuk paraqiti pretendime lidhur me parashikimin e politikave të privatësisë në faqen zyrtare në internet, (www.amf.gov.al) dhe mangësitë në plotësimin e Formularit të njoftimit.

Për sa më sipër:

Në zbatim të neneve 29, 30 dhe 32 të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, i ndryshuar, si dhe 107-109 të Kodit të Procedurave Administrative:

REKOMANDOJ :

1. Në zbatim të nenit 18 të Ligjit Nr. 9887, datë 10.03.2008, “Për mbrojtjen e të dhënave personale” i ndryshuar, kontrolluesi “Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare” (AMF), të informojë paraprakisht subjektet e të dhënave, “nëpunës” dhe “subjekte të mbikëqyrura”, (agjentë, brokera, konsulent financiar etj.), për të dhënat që mblidh nëpërmjet kontratës së punës, (për nëpunësit) si dhe në formularët e aplikimit për pajisje me licencë, (për subjektet e mbikëqyrura), për fushën dhe qëllimin për të cilin përpunohen të dhënat, për personin që do të përpunojë të dhënat, për mënyrën e përpunimit, për të drejtën për akses si dhe të drejtën për korrigjim të të dhënave personale të tyre.
2. Në zbatim të nenit 18 të Ligjit nr. 9887, datë 10/03/2008, “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale” i ndryshuar, në faqen zyrtare të kontrolluesit në internet, www.amf.gov.al, të publikohen në një rubrikë të veçantë “Politikat e privatësisë”, me qëllim, informimin e personave që vizitojnë faqen, mbi mënyrat e përpunimit të të dhënave personale, masat e sigurisë dhe ruajtjes së konfidencialitetit, të drejtat e subjekteve të të dhënave dhe detyrimet që kontrolluesi ka, në kuadër të mbrojtjes së privatësisë. (Në plotësimin e kësaj pike të Rekomandimit të mbahet parasysh Opinioni i Komisionerit “Mbi mbrojtjen e të

Dhënave Personale në Faqen e Internetit të Kontrolluesve Publik dhe Privatë”, i cili gjendet i publikuar në faqen zyrtare www.idp.al).

3. Në zbatim të nenit 21 të Ligjit nr. 9887, datë 10/03/2008, “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale” i ndryshuar, të bëhet përditësimi i Formularit të Njoftimit në rubrikat e konstatuara në proces-verbalin e kontrollit.
4. Detyrimet e rëndësishme, të parashikuara në pikat 1 dhe 2 të këtij Rekomandimi, të realizohen brenda një afati kohor prej, 45 (dyzetë e pesë) ditësh, ndërsa detyrimi i parashikuar në pikën 3 të këtij Rekomandimi, të realizohet brenda një afati kohor prej 5 (pesë) ditësh nga momenti i marrjes dijeni të këtij Rekomandimi;
5. Në zbatim të nenit 32/1 të Ligjit nr. 9887, datë 10/03/2008, “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale” i ndryshuar, me plotësimin e këtyre detyrimeve të njoftohet me shkrim pranë Komisionierit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale;
6. Me kalimin e këtij afati në rast mospërbushje të këtyre detyrimeve, Komisioneri vepron sipas nenit 30, pika 2 të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, i ndryshuar. Komisioneri në rast shkeljesh serioze, të qëllimshme të ligjit nga një kontrollues ose përpunues, veçanërisht në rastet e përsëritura të moszbatimit të rekomandimeve të tij, vendos sanksione për kundërvajtjet administrative dhe e denoncon publikisht ose e raporton çështjen në Kuvend dhe në Këshillin e Ministrave.

BESNIK DERVISHI

